



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 05.11.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, QË NDRYSHON MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN”

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.11.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantoi projektligjin, Znj. Rovenë Voda, Zëvendësministre e Brendshme, Znj. Alma Mehmeti, Shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Brendshme, Znj. Silvana Dervishi, Specialiste në Ministrinë e Brendshme, Z. Ilir Bejko, Drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji, ka si qëllim ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, i cili ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë të BE-së.

Memorandumi ekzistues, i ratifikuar me ligjin nr 11/2017 përfshin tri komponentë që i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, por nuk përfshin pjesën e katërt të komponentit që lidhet me politikën e luftës lundër drogave.

Propozimi për ndryshimin e këtij memorandumit ka ardhur nga Ministria e Brendshme me anë të një shkrese drejtuar Komisionit Evropian, me qëllim që Shqipëria të përfshihet edhe në pjesën e katërt të komponentit: “Politika e luftës kundër drogave”, të programit të drejtësisë së BE-së. Ky ndryshim paraqitet i nevojshëm, pasi për një pjesëmarrje të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duhet të mbulohet edhe objektivi i programit të drejtësisë të BE-së që lidhet me lëndët narkotike.

Ky ndryshim i memorandumit synon të mundësojë rritjen e efikasitetit të institucioneve ligjzbatuese në luftën kundër lëndëve narkotike dhe të mbështesë iniciativat mbi bashkëpunimin gjyqësor dhe aspektet e parandalimit dhe luftimit të krimit.

Në projektvendimin e Komisionit Evropian, që amendon memorandumin e mirëkuptimit mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e drejtësisë së BE-së, është shtuar edhe pjesa e katërt e komponentit “Politika e luftës kundër drogave”, e cila ka si pjesë të saj edhe elementin e kontributit financiar.

Kontributi financiar për objektivin (d)* do të mbulohet nga Ministria e Brendshme, për secilin vit buxhetor. Ky kontribut do të mbulohet nga buxheti i programit “Policia e Shtetit”.

Diskutimet në Komision :

Deputetët në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjet dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive, ndalën dhe diskutuan mbi arsyet e ndryshimit të memorandumit dhe rëndësinë që sjell pjesëmarrja e Ministrisë së Brendshme në këtë memorandum të ndryshuar.

Pas shqyrtimit të projektligjit, Komisioni e votoi dhe miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshjet ndërkombëtare.’”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI